



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1044/4 Prot.

Tiranë, më 19.10.2023

V E N D I M

Nr. 204, Datë 19.10.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.187 Regj., datë 25.09.2023, që i përket ankueses Znj.E. C, kundër Kompanisë “Yura Corporation Albania” sh.p.k, me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Znj. E. C, ka parashtruar në ankesë se, ka qenë e punësuar pranë Kompanisë “Yura Corporation Albania” sh.p.k, që në datën 02.07.2021, me kontratë një vjeçare në pozicionin operatore. Gjithçka ka qenë në rregull në lidhje me punën e saj deri në momentin që është përballur me një problem serioz shëndetësor dhe kishte nevojë për një trajtim kirurgjikal në fund të muajit janar 2023. I është nënshtruar menjëherë ndërhyrjes kirurgjikale në Spitalin e Fierit dhe ndërhyrjen e ka kryer në datën 23.02.2023.

Duke qenë se operacioni kërkonte kohë për rikuperim ka qëndruar e shkëputur nga puna për afërsisht 4 muaj dhe e ka vënë në dijeni punëdhënësin e saj për situatën nëpërmjet raporteve mjekësore. Gjatë kohës së rikuperimit është kontaktuar nga punëdhënësi dhe është pyetur se kur do të rikthehej në punë, por ende nuk kishte mundësi fizike pasi nuk e komandonte dot dorën dhe krahun.

Pas rikuperimit është rikthyer në punë në datën 08.06.2023, ku është pyetur nga punëdhënësi nëse ishte e sigurt që kishte fituar aftësinë për të punuar. I është përgjigjur që ishte e aftë për punë dhe ka punuar deri në datën 30.06.2023, datë e cila përputhet me afatin e mbarimit të

kontratës. Ndërkohë, një javë para se të përfundonte kontrata i është komunikuar në mënyrë verbale në zyrë se do t'i ndërpriteshin marrëdhëniet e punës për arsye se Kompania nuk mban në punë njeri me probleme shëndetësore, edhe pse në komunikimin zyrtar janë shprehur thjesht për mosrinovim kontrate. Verbalisht i është komunikuar që largimi i saj nga puna ka ardhur me urdhër të shefit të madhë të Kompanisë, i cili e ka deklaruar që nuk mban në punë njëri të sëmure.

Në të njëjtën situatë ka qenë dhe kolegja e saj znj. Mira, e cila ka munguar afërsisht një muaj e gjysëm për shkak të humbjes së nënës, të dyjave i është komunikuar largimi, por ajo që u largua në fund ishte ankuesja. Kjo gjë e ka bërë ankuesen të mendojë se ky largim ka ardhur nga liderja znj. M. Z, e cila që në ditën kur u bë lidere para një vit e gjysëm është përpjekur t'a nxjeri të paaftë në punën e saj, gjithmon ka pasur një mospëlqim ndaj saj dhe ajo shfrytëzoi momentin e gjendjes së saj shëndetësore për të bërë veprimin final. Ankuesja ngre dyshimet e saj, se liderja ka për detyrë të kërkojë të dorëzojnë kartën e *chek in* dhe jelekun e punës, të cilat nuk i janë kërkuar të dorëzohen dhe këtu i ka lindur dyshimi se nuk është pushuar nga shefi i madhë i Kompanisë. Largimin e saj nga puna e quan të padrejtë, pasi pavarësisht problemit të saj shëndetësor që ka kaluar ajo është plotësisht e aftë për të punuar.

Në përfundim, ankuesja kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Kompanisë “Yura Corporation Albania” sh.p.k, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe rikthimin në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 187, datë 25.09.2023, të bërë nga znj. E. C, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Me shkresën nr. 1044/1, datë 02.10.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Kompania “Yura Corporation Albania” sh.p.k, për ankesën e bërë nga znj.E. C, si dhe ka kërkuar aktet e mëposhtme:

- Informacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e znj. E. C.
- Kopje të dosjes personale të ankueses, kopje të librezës dhe kontratës/kontratave të punës të lidhura me ankuesen.
- Kopje të vendimit të lirimimit nga detyra të ankueses, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqëruar dhe procedurën e ndjekur (njoftime, procesverbale, urdhra, gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës dhe lirimimit të saj, si dhe çdo akt ose informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje)

- Informacion dhe kopje të procedurës së plotë të ndjekur nga ana e Shoqërisë, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me subjektin ankues dhe shkaqet e moslidhjes së kontratës së re.
- Informacion nëse pozicioni që ka ushtruar ankuesja është shkurtuar, nëse po cilat janë arsyet e shkurtimit të pozicionit të punës. Nëse pozicioni i punës nuk është shkurtuar, të na vini në dispozicion dosjen e plotë personale të personit të emëruar në këtë pozicion me shpjegimet përkatëse.
- Informacion të plotë nëse në momentin e lidhjes së kontratës një vjeçare të punës me ankuesen janë lidhur edhe kontrata me punonjës të tjerë me këtë afat, nëse po, të na informoni nëse ju është rilidhur përsëri kontrata këtyre punonjësve.
- Informacion nëse në këtë periudhë shoqëria ka marrë në punë punonjës të tjerë dhe janë lidhur kontrata të reja. Informacioni të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
- Informacion në lidhje me punonjësen me emrin Mira të cilës i është rinovuar kontrata e punës me shoqërinë.
- Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Në vijim ankuesja me shkresën¹ e dërguar me e-mail-in datë 11.10.2023, nëpërmjetë një Deklarate, informoi Komisionerin se tërhiqet nga ankesa nr.187, datë 25.09.2023, për arsye të arritjes së efektivitetit, pasi Kompania “Yura Corporation Albania” sh.p.k, pas ankesës drejtuar Komisionerit nga Mbrojtja nga Diskriminimi, ka rilidhur marrëdhëniet e punës.

Fakti i mësipërm është konfirmuar me shkresën nr. 244 prot., datë 12.10.2023 nga Kompania “Yura Corporation Albania” sh.p.k, e cila ndër të tjera informon se vendosi ripunësimin e znj. E. C, në datën 16.10.2023, në një nga departamentet e Kompanisë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 187, datë 25.09.2023, të znj. E. C, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA